

VENDIM
Nr.343, datë 20.5.2005

MBI ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT RADIOFONIK VENDOR
PRIVAT “ENERGY”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë“, vendimit të KKRT-së nr.200, datë 26.12.2003, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë“ të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin mars, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “NRG Multimedia” sh.p.k. për radion vendore private “Energy”, me nr.licence 051/FML, në rrethin e Elbasanit.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe i nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet Departamenti Teknik, Departamenti Ekonomik dhe Departamenti Juridik dhe i Licencave për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Halil Lalaj